



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
K R Y E S I A

Nr. 24 prot.

Tiranë, më 07. 01.2020

V E N D I M

Nr. 6, datë 07.01.2020

**Për fillim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim
në titullin akademik**

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 07.01.2020; në mbështetje të ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë; dhe nenit 7, pika 5-12 të Statutit. Pasi u njoh me kërkesën për shpallje interesi për avancim në titullin *akademik* të dy anëtarëve të Asamblesë, akad. asoc. Ilirjan Malollari dhe akad. asoc. Arian Durrësi;

V e n d o s i :

1. Fillimin e procedurës së avancimit të tyre për titullin *akademik*;
2. Komisioni teknik të ndërmarrë verifikimet e nevojshme në zbatim të ligjeve në fuqi dhe të paraqesë raportin, deri më datë 15 shkurt 2020.
3. Seksioni i Shkencave Natyrore Teknike të ushtrojë kompetencat e tij sipas nenit 7, pika 10 të Statutit, bazuar dhe në kërkesat e **Aneksit nr.2**, deri më datë 15 mars 2020.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore Teknike;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

